




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezuar Priljenoi/Prudato Received/Delivered	19.09.2022	viti god year	
Organ /Bjesta Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTOK	5491/2022	1/7	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.695/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.695/2022 të datës 10.08.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë fshati

███ në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 19.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.695/2022 e datës 10.08.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 01-Nr.-016-47927 i datës 03.08.2022 i Komisionit Vlerësues të Komunës së Suharekës dhe Njoftimi me numër 01-Nr-016-46561 i datës 29.07.2022 i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës.

A r s y e t i m

Komuna e Suharekës duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 05.04.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 26.04.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë Ligjor me numër të referencës RN00008770 lidhur me pozitën "Zyrtar ligjor 1" në Zyrën e Kryetarit, "Zyrtar ligjor 1" në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër, "Zyrtar ligjor 1" në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, "Zyrtar ligjor 1" në Drejtorinë për Arsimit dhe "Zyrtar për çështje pronësore" në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër/Sektori për Shërbime Pronësore Juridike, për klasën e pozitës Profesional 3.

Ankuesja [REDACTED] me datën 04.05.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë ka qenë e përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë, bazuar në njoftimin me numër 01-Nr-016-46561 të datës 29.07.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës, e njëjta është njoftuar lidhur me pikët e arritura, gjithsejtë 67.4 pikë, duke u renditur e njëzeta (20) në listën përfundimtare.

E pa kënaqur me rezultatin përfundimtar mbi përzgjedhjen e kandidatëve fitues, me datën 29.07.2022, ankuesja ka parashtruar ankesë tek Komisioni për vlerësim, me pretendimet ankimore se pikët e testit me shkrim janë manipuluar nga ana e komisionit të pranimit, se e njëjta nuk është vlerësuar korrekt lidhur me vlerësimin e CV-së si dhe nuk është vlerësuar meritokracia mirëpo janë pranuar kandidatët me librezë partiake.

Me datën 03.08.2022, Komisioni për vlerësim, përgjegjës për vlerësimin e procedurave të lartcekura në Komunën e Suharekës, ka nxjerrë Vendimin me numër 01-Nr-016-47927, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar dhe e ka lënë në fuqi Njoftimin me numër 01-Nr-016-46561 të datës lidhur me rezultatin përfundimtar mbi përzgjedhjen e kandidatëve fitues.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin e komisionit të vlerësimit në Komunën e Suharekës lidhur me refuzimin e ankesës se saj si dhe vendimit lidhur me rezultatin përfundimtar mbi përzgjedhjen e kandidatëve fitues, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 10.08.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4626/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se pikët e testit me shkrim janë manipuluar nga ana e komisionit të pranimit, se e njëjta nuk është vlerësuar korrekt lidhur me vlerësimin e CV-së si dhe nuk është vlerësuar meritokracia mirepo janë pranuar kandidatët me librezë partiake.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës konform dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 12.08.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Suharekës, ndërsa me datën 23.08.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Suharekës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me Nr.Prot:4626/2022 të datës 10.08.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin 01-Nr-016-47927 të datës 03.08.2022 të Komisionit për Vlerësim; Njoftimin e datës 29.07.2022 me numër 01-Nr-016-46561 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës; Cv-në e ankueses së bashku me postimet përmes rrjetit social facebook të vitit 2019 dhe 2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 12.08.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 23.08.2022 nga Komuna e Suharekës lidhur me provat e bashkëngjitura të lëndës; Vendimin me numër 01-Nr-410-34407 të datës 09.06.2022 të Kryetarit të Komunës së Suharekës; Autorizimin

me numër 01-Nr-016-19497 të datës 31.03.2022 lidhur me shpalljen e konkursit nga Komuna e Suharekës; Njoftimin me numër 01-Nr-016-20586 të datës 06.04.2022 lidhur me publikimin e konkurseve; Konkursin me numër të referencës të datës 05.04.2022; Renditjen përfundimtare të kandidatëve e datës 03.08.2022 e gjeneruar në SIMBNJ; Njoftimin me numër 01-Nr-016-47920 të datës 03.08.2022 nga Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Suharekës ; Njoftimin me numër 01-Nr-016-46561 të datës 29.07.2022 nga Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Suharekës; Njoftimin me numër 01-Nr-016-38691 të datës 29.06.2022 nga Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Suharekës; Njoftimin me numër 01-Nr-016-31254 të datës 26.05.2022 nga Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Suharekës; Njoftimin me numër 01-Nr-016-29590 të datës 19.05.2022 nga Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Suharekës; Formularin e vlerësimit lidhur me kriteret e zgjedhjes së ngushtë të datës 19.05.2022; Listën e aplikantëve të aprovuar, të refuzuar dhe në pritje të gjeneruar në SIMBNJ; Aplikacionin e kandidatit _____ të datës 08.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, formularët e vlerësimit, ID-në dhe certifikatën nga gjykata; Pyetjet e testimit me gojë; Procesverbalin e datës 18.07.2022 të Komisionit intervistues lidhur me rastin e vlerësimit të cv-ve të kandidatëve; Aplikacionin e kandidates _____ të datës 06.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, formularët e vlerësimit, ID-në dhe certifikatën nga gjykata; Aplikacionin e kandidatit _____ të datës 07.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, formularët e vlerësimit, ID-në dhe certifikatën nga gjykata; Aplikacionin e kandidates-ankueses _____ të datës 04.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, formularët e vlerësimit dhe certifikatën nga gjykata; Ankesën e ankueses të datës 29.07.2022 e parashtruar tek Komisioni i vlerësimit në Komunën e Suharekës; Procesverbalin e datës 03.08.2022 të Komisionit intervistues të Komunës së Suharekës; Aplikacionin e kandidates _____ të datës 26.04.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, formularët e vlerësimit, ID-në dhe certifikatën nga gjykata; Aplikacionin e kandidatit _____ të datës 29.04.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, formularët e vlerësimit, ID-në dhe certifikatën nga gjykata.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses _____ është e pabazuar, sepse:

Pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit „Specialist ligjor”, në Komunën e Suharekës, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00008770 lidhur me pozitat “Zyrtar ligjor 1” në Zyrën e Kryetarit, “Zyrtar ligjor 1” në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër, “Zyrtar ligjor 1” në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, “Zyrtar ligjor 1” në Drejtorinë për Arsim si dhe “Zyrtar për çështje pronësore” në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër/Spektori për Shërbime Pronësore Juridike, për klasën e pozitës Profesional 3, kanë qenë si në vijim:

- **Arsimi i kërkuar:** Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS-Fakulteti Juridik.
- **Kualifikime të posaçme:** Fakulteti Juridik.
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Nuk kërkohet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të provave dhe pretendimeve ankimore të ankueses, ka konstatuar se për pozitat e lartcekura kanë aplikuar katërdhjetë e nëntë (49) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përfshirë katërdhjetë e katër (44) kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja. Pas përfundimit të procedurave të pranimit, vlerësimit paraprak, vlerësimit të intervistës me gojë dhe vlerësimit të jetëshkrimit, ankuesja nga ky proces është vlerësuar me pikë të përgjithshme prej 67.2 pikë gjithsejtë dhe se e njëjta është vlerësuar nga Komisioni i pranimit në pajtim me nenin 16 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: *"1.Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Pranimit i themeluar në pajtim me nenin 17 dhe/ose përkatësisht nenin 18 të kësaj Rregulloreje. 2.Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit/CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë"*, ndërsa pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankueses se e njëjta nuk është vlerësuar meritorisht dhe i është bërë diskriminim nga ana e Komisionit të vlerësimit, Kolegji ka konstatuar se ky pretendim është i pa bazuar dhe jo ligjor, pasi që në rastin konkret ankuesja me datën 29.07.2022 sipas Njoftimit me numër 01-Nr-016-46561 është njoftuar lidhur me rezultatet e vlerësimit për pozitat e lartcekura, i shpallur nga Udhëheqësi i Personelit në Komunën e Suharekës, e cila ka fituar pikët e përgjithshme prej gjithsejtë 67.2 pikë, duke u renditur e njëzeta (20) në listën përfundimtare të këtij njoftimi.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale tek vlerësimi CV-së, pasi që e njëjta është vlerësuar nga Komisioni vlerësues me vetëm tetë (8) pikë edhe pse ka pasur trajnime të përfunduara, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të nenit 22 paragrafit 1, 2 dhe 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin është përcaktuar se: *"1.Pas testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me vlerësimin e jetëshkrimit. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet"*, ka konstatuar se Komisioni i Vlerësimit në bazë të dokumentacioneve ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit për kandidatët ku ankuesja është vlerësuar me gjithsejtë 8 pikë, konkretisht tek pjesa *për cilësinë dhe nivelin e arsimimit ankuesja është vlerësuar me piket maksimale*, ndërsa lidhur me pretendimin ankimor se të njëjtës nuk i janë vlerësuar trajnimet nga ana e Komisionit të Vlerësimit, Kolegji pasi ka analizuar dosjen e ankueses e dorëzuar me rastin e aplikimit, ku e njëjta si dëshmi të trajnimeve ka dorëzuar Certifikatën me numër No.4903 të datës 08.05.2008, e lëshuar nga English Language Centre ELC në Prishtinë , lidhur me ndjekjen e orëve për gjuhën angleze dhe testimin përfundimtar, Certifikatën me numër No.5770 të datës 12.03.2009, e lëshuar nga English Language Centre ELC në Prishtinë , lidhur me ndjekjen e orëve për gjuhën angleze dhe testimin përfundimtar si dhe Certifikatën me numër E-04/2010 të datës 01.07.2010 e lëshuar nga Top School në Prishtinë për ndjekjen e kursit trajnues për programin kompjuterik word 2007, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, sepse ankuesja me certifikatat e mësipërme nuk ka arritur të dëshmojë se ka përfunduar trajnime për fushat specifike përkatëse, mirëpo ka përfunduar vetëm kurse që lidhen me njohjen e gjuhës angleze dhe atë të kompjuterëve, e që në rastin konkret vlerësimi për këtë pjesë është bërë në mënyrë të drejtë nga ana e Komisionit të vlerësimit dhe në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafit 4 nën paragrafit

4.3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës, me datën 29.07.2022 ka publikuar Njoftimin me numër 01-Nr-016-46561 lidhur me renditjen përfundimtare për rezultatet e vlerësimit për grupin e pozitive „Specialist ligjor” lidhur me pozitën “Zyrtar ligjor 1” në Zyrën e Kryetarit, “Zyrtar ligjor 1” në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër, “Zyrtar ligjor 1” në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, “Zyrtar ligjor 1” në Drejtorinë për Arsim si dhe “Zyrtar për çështje pronësore” në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër/Sektori për Shërbime Pronësore Juridike, për klasën e pozitës Profesional 3, në të cilën janë përfshirë emrat e kandidatëve sipas pikëve të arritura dhe të përzgjedhur në bazë të pikëve si në vijim: _____ me gjithsejtë 82 pikë të arritura, _____ me gjithsejtë 80.8 pikë të arritura, _____ me gjithsejtë 79.8 pikë të arritura, _____ me gjithsejtë 78.6 pikë të arritura dhe _____ me gjithsejtë 78 pikë të arritura, andaj ndërlidhur me këtë Kolegji konstaton se publikimi nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore e Komunës së Suharekës, është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin përcaktohet se: “2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues”, dhe në këtë kuptim ankuesja është renditur e njëzeta (20) në këtë listë me gjithsejtë 67.2 pikë të arritura, e që bazuar në dispozitën e lartcekur e njëjta nuk ka arritur të mbledh pikët e mjaftueshme për tu përzgjedhur në radhët e kandidatëve fitues andaj edhe pretendimi ankimor i ankueses në kuptim se e njëjta nuk është vlerësuar drejtë nga ana e Komisionit të vlerësimit është i pa bazuar dhe jo ligjor. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor të ankueses se për pozitën e lartcekura janë përzgjedhur kandidatët që mbajnë librezë partiake, Kolegji ka konstatuar se nuk posedon dëshmi në shkresat e lëndës me të cilën vërtetohet se të njëjtit mbajnë apo ushtrojnë pozita politike, andaj edhe pretendimi i tillë nga ana e ankueses është i pa bazuar mbi faktin se nuk është argumentuar me prova konkrete bazuar në legjislacionin në fuqi të shërbimit civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga Komuna e Suharekës lidhur me dosjet e kandidatëve të përzgjedhur lidhur me pozitën e lartcekura dhe ka konstatuar se Komisioni i Pranimin dhe Karrierës së kandidatëve _____ dhe _____ për grupin e pozitive „Specialist ligjor” lidhur me pozitën “Zyrtar ligjor 1” në Zyrën e Kryetarit, “Zyrtar ligjor 1” në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër, “Zyrtar ligjor 1” në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, “Zyrtar ligjor 1” në Drejtorinë për Arsim si dhe “Zyrtar për çështje pronësore” në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër/Sektori për Shërbime Pronësore Juridike, për klasën e pozitës Profesional 3, si kandidatët të cilët kanë fituar grumbulluar pikë më së shumti në raport me kandidatët e tjerë, ka vepruar në pajtim me nenin 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: “neni 24. Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në se cilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit”. Ndërlidhur me përvojën profesionale të kandidatëve të përzgjedhur nga kjo procedurë e rekrutimit, kolegji ka analizuar dëshmitë lidhur me dosjet e kandidatëve të përzgjedhur dhe ka konstatuar si në vijim: kandidati Sh. Bytyqi posedon Diplomën me numër Nr.2687 të datës 14.07.2014, të lëshuar nga Universiteti

i Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilin dëshmohet se ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik me datën 25.04.2014 dhe ka marrë titullin Jurist i diplomuar-Bachelor, kandidatja [redacted] posedon Diplomën me numër Nr.2633/19 të datës 05.12.2019, të lëshuar nga Kolegji "AAB" me të cilin dëshmohet se ka përfunduar studimet në programin Juridik me specializim Juridik i Përgjithshëm me datën 25.11.2019 dhe ka fituar gradën LLB në Juridik, kandidati [redacted] posedon Diplomën me numër Nr.768 të datës 16.11.2020, të lëshuar nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" me të cilin dëshmohet se ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik me datën 26.10.2020 dhe ka marrë titullin Bachelor në Juridik, kandidatja [redacted] posedon Diplomën me numër Nr.260 të datës 18.09.2016, të lëshuar nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" me të cilin dëshmohet se ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik me datën 06.09.2016 dhe ka marrë titullin Bachelor në Juridik dhe kandidati [redacted] posedon Diplomën me numër Nr.185/0612 të datës 28.06.2012, të lëshuar nga Kolegji "Fama" me të cilin dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore universitare në programin Juridik me datën 28.09.2011 dhe ka fituar gradën LLB në Juridik, andaj ndërlidhur me kriteret e konkursit për fushën e arsimimit, Kolegji ka konstatuar se kandidatët e përzgjedhur për pozitën e lartcekura i plotësojnë kushtet e konkursit lidhur me fushën e arsimimit të kërkuar, ngase të gjithë kanë ofruar dëshmi se posedojnë diplomat lidhur me përfundimin e studimeve themelore nga fusha e drejtësisë-fakulteti juridik e kërkuar me konkurs.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se Zyra e Personelit në Komunën e Suharekës, me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare sipas Njoftimit me numër 01-Nr-016-46561 të datës 29.07.2022 lidhur me renditjen përfundimtare për rezultatet e vlerësimit për grupin e pozitave „Specialist ligjor“, për pozitën "Zyrtar ligjor 1" në Zyrën e Kryetarit, "Zyrtar ligjor 1" në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër, "Zyrtar ligjor 1" në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, "Zyrtar ligjor 1" në Drejtorinë për Arsim si dhe "Zyrtar për çështje pronësore" në Drejtorinë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër/Spektori për Shërbime Pronësore Juridike, për klasën e pozitës Profesional 3, si dhe Vendimi me numër 01-Nr.-016-47927 i datës 03.08.2022 i Komisionit Vlerësues të Komunës së Suharekës, kanë vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe nenin 25 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.695/2022, datë 19/09/2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Anben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses
- ❖ Kryetarit të Komunes së Suharekës;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

